



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 4852 Prot.

Tiranë, me 03/10/2025

URDHËR

Nr. 239, datë 03/10/2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të shkronjës “dh” të nenit 37 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Kancelarit të Gjykatës së Lartë, për përfaqësimin ligjor të institucionit të Gjykatës së Lartë në proceset gjyqësore, në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë si dhe në Gjykatën Kushtetuese.
2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Gjykatës së Lartë në proceset gjyqësore të nënshkruhen nga Kancelari, në emër të personit apo personave që do të përfaqësojnë institucionin e Gjykatës së Lartë.
3. Përfaqësuesi i autorizuar nga Kancelari ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara gjykatave, prokurorisë, zyrave të përmbarimit gjyqësor, Gjykatës Kushtetuese konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.
4. Ngarkohet Kancelari i Gjykatës së Lartë për zbatimin e këtij urdhri

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
SOKOL SADUSHI

